



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/18/24

Datë: 30.08.2024

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/1-040, GZRRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), nenit 16 paragrafi 9 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1. të Rregullores mbi transparencën, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 30.08.2024 nxjerrë:

V E N D I M

për hapjen e diskutimit publik për
projekt Rregulloren për taksa ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2025

- I. Me këtë vendim hapet diskutimi publik për projekt Rregulloren për taksa ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2025 /në tekstin e mëtejme projekt Rregullorja/.
- II. Projekt Rregullorja nga pika I. e këtij vendimi vëhet në dispozicion të publikut për shqyrtim publik dhe komente.
- III. Të gjitha propozimet dhe vërejtjet që paraqiten nga publiku brenda afatit kohor prej 15 ditëve do të përfshihen në raportin e shqyrtimit publik.
- IV. Ekspozimi i projekt Rregullores do të bëhet në zyrën për buxhet dhe financa të objektit të Komunës së Junikut.
- V. Diskutimi publik i projekt Rregullores zgjat 15 ditë (fillon më: 02.09.2024 dhe përfundon më: 16.09.2024).
- VI. Gjatë kohës së diskutimit publik projekt Rregullorja ekspozohet edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe komente.
- VII. Diskutimi publik i projekt Rregullores organizohet nga Komuna e Junikut respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.
- VIII. Organizatori është i obliguar që të hartojë planin e veprimit dhe organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së diskutimit publik të kësaj projekt Rregulloreje.
- IX. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.
- X. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesori i Kuvendit
Z. Shqipëri

